

Të dielën vonë në mëngjes, kur ishte ende në shtrat i shkalafitur nga ca ëndrra të poshtra, por i lirë të ngrihej vonë, Madhori i telefonoi e i tha gjithë nerva se *ajo* kishte botuar një tregim në gazetën *Life&Culture*. Hidhi një sy mutit, hungërroi, se më duket e ka për mua. Më polli me atë bukëshkalë.

Fatmiri përplasi dorezën e telefonit dhe shtrëngoi dhëmbët. Enigmat e tua me të do të zgjidh unë, Shef?, foli gati me zë dhe u ngrit. Si dreqin ia ke mbushur mendjen të të jepej? Si e ke kandisur, në ç'pjesë të trupit e ke prekur fillimisht? Teksa fshihej me peshqir sytë i kishte me lot. Dhe kur jeni mbyllur në dhomë dhe ke zhveshur së pari trupin e saj... o Zot... dhe kur ajo lakuriq është mbështjellë e verbuar epshit rreth trupit tënd lakuriq duke gulçuar nga ekstaza si je ndier, Shef?

Ndërkohë që ecte trotuarit drejt kioskës për të blerë gazetën i shungullonin fjalët e Olsit se arsytet e sulmeve të saj kundër Madhorit duhej t'i kishin rrënjët në aferën e tyre.

U kthye në shtëpi, doli në ballkonin që binte nga deti, u shtri në shezlong dhe nisi të lexonte tregimin.

Në tribunën festive të zbukuruar me shirita e lule binin në sy dy portrete gjigante të Shaban Tollumbit, kandidatit për deputet, që kishte dalë në tribunë. Edhe njerëzit e mbledhur në shesh mbanin në duar portrete të Shabanit dhe flamurë partiakë.

- Të dashur bashkëqytetarë, - buçiste zëri i tij në altoparlant, - duke m'i dhënë votat mua, ju ia jepni birit tuaj, një biri të denjë... Unë do të përpiqem me të gjitha forcat ta justifikoj besimin tuaj! Do të luftoj me mish e me shpirt për mirëqenien tuaj, për lumturinë tuaj!

Turmat bërtisnin të elektrizuara duke tundur flamujt, pankartat dhe portretet e Shabës.

- Do t'i jap fund trafikut të qenieve njerëzore, kësaj tragjedie të tmerrshme që po merr jetë njerëzish të pafajshëm... Do t'i zhduk katilat që po pasurohen në kurriz të jetës suaj dhe të fëmijëve tuaj! Ju do të shkoni përtej detit të sigurt! Për ata që s'do të shkojnë do të hap vende pune... Premtoj se do t'ju nxjerr nga mjerimi nëse më jepni votat!

Bregu shkëmbor ndriçohej zbehtë nga një hënë e ngrënë dhe retë e errëta vraponin në qiell si kumte kobzeza. Frynte erë, dallgët rrihnin shkëmbinjtë duke u thyer në stërkala të xhevahirta... dhe shndritja e kreshtave në det shpërndahej në mijëra skërmitje të frikshme.

Në breg përhihej një gomone që tundej dhe pranë saj nxinte një grumbull njerëzish - burra, gra e fëmijë. Shpirtrat e tyre tallaziteshin më fort se deti. Shpresat u nanuriteshin në imazhet e bardha të së ardhmes. Mjerimi sfidon tmerrin dhe shpresa është më e fuqishme dhe më e bukur kur rritet në kalbësirën e ekzistencës si një zambak i bardhë në pleh.

Një djalë i ri mjekrosh me emrin Zak po kontrollonte motorin, kurse shoqëruesi i tij sillte bidona me benzol. Kur hëna dilte nga retë drita e saj i binte Zakut në fytyrë duke e bërë të dukej e tejbotshme.

Një burrë i ri me gruan e me një vajzë të vogël ecnin përgjatë bregut. Vogëlushja shtrëngonte në gji një kukull të vjetër hundëthyer.

- Mami, kukullat atje janë më të bukura?

- Po, shpirt.

U dëgjua një uturimë dhe në qiell u shfaq një helikopter si një korb i zi që u ul përtej gjirit. Dritat e tij regëtinin si shkëlqime ogurzeza yjesh të mbërthyer në metal dhe thikat e tij, që rrotulloheshin frikshëm, dukeshin sikur kërkonin të prisnin koka... Shabani nxori celularin dhe telefonoi.

Zaku u nis me një trandje në zemër. E priste atë përballje, e pati bërë me mend dialogun, kishte rikujtuar një varg nga një baladë e vjetër kreshnikësh që i qe fiksuar që në shkollë dhe qe trimëruar disi, por tek bënte hapat e fundit drejt shpendit të errët ndjeu se guximi iu shkërmoq si sajnat për shkëmbi. Shabani e priti me këmbët e para.

- Pse s'je nisur?

- Deti është i trazuar, shef.

Shabani pa nga deti a thua se tani e vuri re se ndodhej pranë tij. Hëna doli nga retë dhe ia ndriçoi fytyrën që u shfaq e ngrirë, si fytyra e një mumjeje. Shungullima e dallgëve kishte një ritëm muzikor të përzishëm dhe Zaku tha me vete se në baladë balozi i zi dilte nga deti, kurse për balozët që zbrisnin nga qielli s'qenë krijuar balada.

- Është i trazuar, por jo i pakalueshëm.

- Është i rrezikshëm.

- Ti ke kaluar në det më të keq.

- Në det si ky jo.

- Në mot të vështirë përqindja është më e lartë.

- S'është puna aty.

- Motori është i ri. Nëse vjen puna për ndihmë, më telefono të nis dy helikopterë.

- Sikur të më zëvendësoni me një tjetër?

- Tani? Ku ta gjej tjetrin tani?

Zaku shihte ujët e zi të detit me dallgët si copëra qefinësh të bardhë të shqyer nga era e çmendur.

- Është lundrim drejt vdekjes, shef.

- Mirë, mos u nis. Më jep 30 mijë dollarë dhe mos u nis.

Zaku psherëtiu. Mirë, do të nisem. Dhe teksa ecte drejt gomones iu kujtuan fjalët e një shoku që kishte shpëtuar nga vdekja në det, por e kishte parë vdekjen me sy. Vdekja më e llahtarshme është vdekja në det, Zak. Lumturia më sublime është kur lahesh në det të qetë me të dashurën. E dashura ime vdekje, psherëtiu Zaku sërish. Më ke kërkuar takim? Mirë, po vij. Po vij me të tjerë, e dashur. Me sa prej nesh ke rënë në dashuri?

Zaku ndezi motorin dhe gomonia u nis shkundullimthi. Klithmat njerëzore mbyteshin nga shakullima e shkalluar e detit...

Shabani hyri në dhomën luksoze të hotelit ku një bjonde e kolme shihte televizor. Shabani e puthi në faqe, u ul në tryezë, hapi leaptopin dhe nisi llogaritjet. Zaku e kishte sfiduar detin... i vetmi që qe nisur. Pilotët që s'qenë nisur do t'i pushonte. Rrinin tridhjetë të tjerë në radhë për një vend pune si pilot.

Ra zilja e celularit dhe Shabani dëgjoi zërin e së shoqes. Sa të ëmbël e ka pasur zërin dikur, mendoi. Tani i ngjan krakërimës së një pulëbardhe në stuhi.

- Do të vish sonte, i dashur?

- Jo, zemër. Jemi në një mbledhje të parlamentit për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore.

- Mirë, shpirt. Nesër më bëj një tel, mirë?

- Patjetër, zemër!

Gomonia hovte përpjetë, binte në humnerë, ngrihej në kulmin e dallgëve, fundosej sërish... Era u përplaste pasagjerëve në fytyrë sajna të furishme. Burri dhe gruaja e kishin mbështjellë vogëlushen me trupat e tyre për ta mbrojtur nga shkullmat e akullta. Gomonia u hodh me aq forcë, sa udhëtarët gati ranë në ujë. Vogëlushja nisi të qante. Gruaja u përkul mbi spond dhe volli. U dëgjua një zë burri që tha:

- Djalosh, ktheje varkën.

- Atë po mendoj, xhaxha.

Shoqëruesi mori drejtimin e gomones, kurse Zaku nxori celularin duke e mbajtur me kujdes që të mos i lagej nga ujët. Edhe pa atë celular e kishte vendosur, por donte të ruante vendin e punës. Mosnjoftimi do të thoshte mungesë respekti për balozin e qiellit. Edhe të detit, tha Zaku me vete duke u mbajtur fort për të mos rënë në det.

Shabani vazhdonte llogaritjet. Mezi e dëgjoi zërin e Zakut që vinte i mbytur për shkak të tërbimit të detit.

- Shef, deti po tërbohet, ndaj po kthehem.

- Do të më paguash 30 mijë dollarë.

- S'është për fajin tim.

- Po të manovrosh, gomonia s'do t'ia dijë. Megjithatë, si të duash.

Gomonia hidhej mbi malet e dallgëve si lëvozhgë arre. Zaku manovroi timonin. Në drej gjoba dhe pushimi nga puna, mendoi. Më e rëndësishme ishte jeta. Jeta e aq njerëzve dhe jeta e tij.

Në largësi u dëgjua një gumëzhimë që vinte herë e dobët e herë e fortë dhe në largësi u dukën dritat e një anijeje. Zaku e njohu, ishte një anije patrulluese, por s'u shqetësua, përkundrazi, u gëzua. Aq më mirë, tha me vete. Më mirë në burg, se i vdekur.

Vazhdoi manovrimin, por kur gomonia u ndodh me brinjë nga era në shpatin e një dallge u përmbys në humnerën e errët dhe pasagjerët ranë në det me britma tmerri. Më të afërtit përpiqeshin të mbaheshin tek sipërfaqja e lëmuar e skafit të saj, por duart u rrëshqisnin.

- Mami! - thërriste vogëlushja. - Babi!

Asnjë përgjigje s'dëgjohej...

Njerëzit përpiheshin prej dallgëve, ngriheshin në kreshta dhe shpejt u zhdukën në atë humnerë të frikshme. Ndonjë luftonte me forcat e fundit. Zaku lutej me vete që anija të vinte sa më parë, por u deshën rreth njëzet minuta derisa mbërriti. Marinarët hodhën goma shpëtimi e litarë. E ëma e vajzës qëndronte e kapur pas një litari, shkundej nga dallgët dhe thërriste emrat e vogëlushes dhe të burrit.

Askush s'përgjigjej, përveç fishkëllimave të erës në direkë e litarë si vaje ngjethëse. O Zot, ndihmë!

Marinarët e krehën detin nën dritën e projektorëve që i bënte dallgët të dukeshin më të frikshme. Në atë tërbim të ujtë s'dukej më njeri i gjallë apo i vdekur. Në kuvertë ishin disa djem që dridheshin nga të ftohtit dhe gruaja që rrinte pranë trupit të pajetë të shoqit.

- Vajzën ku e le, o ditëzi?! O Perëndi, ku është vogëlushja?

Kishte pamjen e një të çmendure; marinarët dhe kapiteni e shihnin me dhembje. Pranë saj ajo pa Zakun me duart në pranga dhe klithi në kulmin e dëshpërimit:

- Më mbyte burrin dhe vajzën! Pse, o Zot, pse?

Dhe ra më gjunjë duke thirrur emrin e së bijës dhe të të shoqit. Dhe duke rrahur dyshemenë e lagur të kuvertës me një rit të lashtë dhembjeje pëshpëriti: As unë s'kam pse jetoj më... Mori hov të hidhej në det, por dy duar të fuqishme e kapën dhe e mbajtën fort dhe butë... si motër dhe si nënë. Dashuria s'ka atdhe, dashuria s'ka kohë, dashuria është e lashtë sa bota dhe e përjetshme sa koha.

Zaku e kishte fytyrën qull nga lotët.

Shabani po bënte takim me elektoratin. Salla ishte plot. Në rreshtin e parë rrinte gruaja e veshur me të zeza.

- Ka ende njerëz të pashpirt që e vazhdojnë trafikun e qenieve njerëzore, - tha Shabani. - Marr pjesë me gjithë zemër në hidhërimin e të afërmëve të viktimave...

Nxori shaminë dhe fshiu sytë.

Ishte një ditë e bukur, bregu ndriste dhe deti shtrihej i qetë me valëzime të lehta. Shabani dhe e dashura e tij rrinin shtrirë në shezlonge e pinin birra.

- Qenka det i mirë, - tha Shabani. - Sonte do të nis dy skafe.

- Ne kur do të shkojmë matanë detit? Më ke premtuar klube, disko, kazino...

- Së shpejti, zemër. Me jahtin tonë, që do ta përurojmë sot. Ja, po vjen.

Bjondja ktheu kokën nga deti.

- Oh, sa i bukur! Sa kushtoi?

- Goxha. Bukuria kushton, e dashur. Siç më kushton ti.

Ndërsa ecte buzë ujit ajo pa një kukull që përkundej nga dallgët. U ul, e mori dhe e vështroi.

- Ç'nuk nxjerr deti, - tha dhe e gjuajti me këmbë në det.

Jahti po afrohej.

Kur e mbaroi së lexuari tregimin, Fatmiri mendoi se Alketa kishte synuar të godiste dukurinë, jo Madhorin. Ai kishte lexuar shumë tregime të saj dhe ky iu duk thjesht ideor, pa një stofë kushedi sa artistike.

U ndje i lehtësuar, Madhori s'do ta ngarkonte me ndërmjetësim. Edhe asaj s'që i detyruar t'ia thoshte mendimin, siç kishte bërë sa herë që ajo botonte gjësend. Do të hesht edhe sikur të botojë kryevepra, tha me vete gjithë pezmi. Rrëfimi i Olsit i kishte ngritur në shpirt një mur betoni mes dy epokash: epoka e dashurisë - e bukur dhe e ndritshme; epoka e pasdashurisë - e errët dhe e urrejtshme.

Ra celulari dhe u habit kur dëgjoi zërin e saj. Kurvë, mendoi, ç'më nget? Sikur të të pyesja për të fshehtë tënde, si do të përlligjeshe që je palluar me vite me një burrë që ka djalin sa ti? Kaq shumë të kënaqte, sa s'të ndahej zemra prej tij? Ç'dreqin ka mbetur pezull mes jush?

Fatmir... Zëri i saj tingëlloi vërtet i trishtuar. Nëse s'do të flasësh, në rregull, po s'kishe pse e hapje telefonin. Ai shkundi kokën dhe u përmend. Më fal, Keti, jam i hutuar, nuk heshta me dashje. Edhe kurva të detyron ta respektosh kur sillet me njerëzillëk, mendoi. Mendo si të duash për mua, Fatmir, por unë mendoj mirë për ty si dikur, si përherë... Mendon ashtu, më braktis, dhe kjo të duket normale? Ndjeu një valë përçmimi për të dhe iu fanit trupi i saj lakuriq pranë trupit të Bedriut lakuriq. Kjo është cinike, deshi t'i thoshte.

Shkrydheshe me të e vije tek unë... dhe tani kërkon të më mallëngjesh. E çekuilibruar. Vajta dhe u ngatërrova me ty. Për t'u çekuilibruar edhe vetë. Për ta bërë zemrën baltë, ku u përplase ti dhe le mbresën tënde që nuk shlyhet më, se zemra ka ngrirë si terrakotë me formën e saj. Punë muti, Keti.

E lexove tregimin? Po. Si t'u duk? Ka ide, por kam lexuar gjëra më të mira prej teje. Ajo qeshi e gëzuar e i tha se atë kishte synuar, idenë. Fati, ke dëshirë të takohemi e të rrimë një copë herë bashkë? Shih. Ca ditë më parë mezi pranoi, tani ma kërkon vetë. Po kjo kështu? Ta ketë marrë Olsi në telefon e t'i ketë thënë, Ia zbraza thesin Fatmirit, dhe me këtë takim kërkon të zbusë gjësend? Jo, Olsi s'është cinik. Ndoshta ka mall, sepse, si çdo kurvë, s'e ka për gjë të kthehet te tavanët e vjetër. Ndoshta s'i kujtohet mirë se ç'ngjyrë ka tavani im. Përse, Keti? Nga të lindi kjo dëshirë? Të kujtojmë ca momente të dikurshme. Kur botoja diçka shkonim te *Shkrimtarët e Detit*. Kam mall për ato kohë. Ah! S'e dija të ishe kaq sentimentale. Jo sentimentale, nostalgjike. Po të dashurit të ri ç'do t'i thuash? E para, Fati, s'jam e dashura e tij. Këtë fiksoje mirë. Toni i saj ishte i rreptë, por ai ndjeu dhimbje në të. E dyta, s'i jap llogari kujt. Ai heshti. Edhe ajo bëri një pauzë, ndoshta e prekur nga heshtja e tij. Si të duash, Fati. Pavarësisht se s'të pëlqeu tregimi, sot më duket vetja pak shumë shkrimtare. Dhe dua të pimë bashkë diçka te klubi i *Shkrimtarëve të Detit*. Tani ishte ai që bëri prapë një pauzë. Mund të shkonte, s'humbte gjë. Në të vërtetë digjej ta shihnte atë kurvë, atë fytyrë që kushedi sa herë ia kishte puthur Shefi i tij dhe dikur edhe i saj. Tmerr. Megjithatë donte t'ia shihnte ata sy të bukur, që tashmë i gëzonte tjetërkush, ndonëse ajo e mohonte. Edhe buzët e bukura, që ia puthte ai tjetri, por që ajo prapë e mohonte. Vërtet, Keti, ç'do të thotë? Ajo u nxeh. S'jam gruaja e tij që t'i marr leje. Në fund të fundit, Fatmir, ty të kam më shumë se atë. Shumë më shumë. Lëri ato, Keti. Mirë, i lashë. Do të vish, apo jo? Mirë. Në ç'orë? Në orën 5 është mirë për ty? Po.

Fatmiri fiku telefonin dhe u shtri përsëri në shezlong me vështrimin nga qielli dhe mendoi se lumturia ekziston kur të plotësohet dëshira e ethshme për diçka të munguar, por që lumturia të jetë e plotë duhet që dëshira të jetë e moralshme, përndryshe ajo që duket lumturi për shkak të plotësimit të dëshirës së hakmarrjes apo të rrëmbimit të diçkaje që i takon një tjetri është një lumturi jetëshkurtër vetëvrasëse. Tani që kishte mësuar një të fshehtë tronditëse të saj s'do ta kishte të lehtë të ishte *vetja e tij* me të, por do të përpiquej të luante lojën e vetes së tij që ajo të mos i binte në të ndryshimit tek ai. S'do t'ia hidhte më fjalën rrotull për rikthim, s'do ta jepte veten se ajo i mungonte, i mungonte gjer në dhembje... me gjithë

atë çapërlimin e saj erotik... që edhe mund t'ia falte. T'ia falte? S'e kishte këtë të drejtë, fal ai të cilit i është bërë keq, por ajo s'i kishte bërë keq posaçërisht atij me dashurinë e saj me Madhorin, sepse atëherë ajo s'e njihnte fare atë farë këshilltari...

Ajo donte të takoheshin te klubi i *Shkrimtarëve të Detit* për të kujtuar diçka nga e kaluara. Eh, Keti. Është pikërisht ajo e kaluar që më çmend, që m'i shkallmon brinjët, ajo e kaluar kur të dija timen dhe s'të ndaja me një tjetër. Kurse ti ndaheshe mes tre burrave. E di veten se ç'je dhe vete e më fton të dalim bashkë, sepse e di që ende të dua. Do të më shkallmosh krejt? Dhe pasi të jemi ndarë dhe ti të kesh shkuar diku me atë tjetrin unë ende të kujtoj shkëlqimin e syve të tu dhe të ndijoj aromën e erzinave të tua dhe të vuaj si dreqi? Përse u dashka kjo, Keti?

Fshiu sytë. Dreqi ta hajë, po përlohem si shpesh këto ditë. S'ka lezet fare.

Klubi i *Shkrimtarëve të Detit* ndodhej në një ndërtesë të vjetër që kishte qenë komisariat policie, çerdhe, bibliotekë dhe poliklinikë derisa u qe dhënë *Shkrimtarëve të Detit*, që mbaheshin për modernë, në dallim nga *Shkrimtarët e Malit*, që merreshin me letërsi tradicionale dhe e kishin klubin në një ish-kazermë.

Teksa i afrohej klubit vështronte pjesën e vjetër të qytetit. I themeluar nga romakët, qyteti qe populluar nga ilirët, por qenë dyndur në të edhe fise nomade kelte dhe teutone, kurse në mesjetë e kishin mësyre tribu malësore arbërore dhe qyteti kishte marrë zhvillim, por qe dëmtuar rëndë nga një tërmet. Sipas një teze, që s'qe vërtetuar shkencërisht, qe rithemeluar nga kolonë të ardhur nga një qytet madhështor verior i quajtur Ulpianë pas shkatërrimit të tij nga dyndjet otomane.

Rrënojat romake e dardane flisnin me gjuhën e heshtur të monumentalitetit të historisë. I bënin përshtypje sidomos mbeturinat e portave të hekurta, të ndryshkura, ku ende ruheshin gjurmët e mjeshtërisë së punimit të hekurit të artizanëve të Ulpianës, muret e rrënuara me tulla të kuqe ndanë të cilave kishin mbirë xinxife, ndonjë pjesë të gurtë që duhej të kishte qenë pedestal i ndonjë perëndëshe ilire a romake. Duke parë ato hije të vjetra të historisë e çapëloi ndjenja e humbjes, e asaj që s'kthehet më, dhe ndjeu dhembje.

Perëndesha ime e humbur, mendoi. Do ta heq përfundimisht nga piedestali i zemrës.

Hynë në sallën e madhe të mobiluar me kolltukë të rrjepur, me tryeza ku qenë vizatuar fusha shahu, etazherë. Në faqen e murit kundruall dritareve ishte bufeja.

Në një tryezë ishte Xha Xhai, Kryetari i *Shoqatës së Qenve*, që po luante shah. I pa të rinjtë, i përshëndeti me një përkulje të kokës dhe vazhdoi lojën. Fatmirit iu kujtua qortimi që ai i pati bërë Jonidës atë natë në Karaoke në *klubin e natës* dhe vuri buzën në gaz. Alketa e pyeti përse qeshte, por s'ia tregoi arsyen, gjeti diçka tjetër. Kam dëgjuar një barceletë për të kur ishte drejtor i Shtëpisë së Kulturës, i tha. Në kohën e diktaturës. Oh, ma trego. Mirë, po kur të ulemi. Tani shkojmë te banaku.

Ç'do të marrësh, Ketì? Ç'të marrësh ti. Unë dua pije të fortë. Edhe unë. *Smirnoff* me aromë molle, mirë? Mirë. Edhe pako me kikirikë e fruta të thata.

I vunë pijet e mezet në tabaka dhe u ulën. Gëzuar, Fatmir. Gëzuar, Ketì. Por në mendje i shkrepiti, Gëzuar, Ketì Kurva. Ketì KaraKurva. Gëzuar, K.K.K.

- Urime për tregimin.

- Po ty s'të pëlqeu.

- Nuk ishte i keq. Por nga ty pres gjëra të shkëlqyera.

Ajo buzëqeshi dhe i shtrëngoi dorën.

- Mirë. Tani më thuaj atë barceletën për Xha Xhanë.

- Në Shtëpinë e Kulturës u bë prova gjenerale e një koncerti muzikor dhe, kur mbaroi, diskutuan njerëz që kishin haber nga muzika. U ngrit edhe Xha Xhai, se helbete, drejtor, dhe u tregua më i rreptë se parafolësit. I kritikoi të gjithë - violinistin, pianistin, kitaristin, flautistin. Kishte mbetur ai që luante në violonçel, por Xha Xhait s'i kujtohej emri i veglës. As ti, i tha violonçelistit, që i bie *kësaj* - dhe lëvizte dorën horizontalisht majtas-djathas përpara barkut të vet - nuk i re hiç mirë.

Alketa qeshi me të madhe. E vërtetë është? Kush e di? Se mos isha këtu atëherë, bëhet fjalë për 20 e ca vjet të shkuara.

Ajo piu pak, hëngri nja dy kikirikë dhe vështroi Fatmirin dhe ai pa se në sytë e saj kishte pikëllim dhe një mendim i thukët ia rrudhte ballin mrekullisht të bukur me ca bashka flokësh që e rrethonin si kurorë dhe në buzët e koralta i endej një kumt i pathënë që përpëlitej të formulohej me fjalë, por një gjyç ia kthente fjalët mbrapsht dhe ato ngrinin në buzë dhe për ta shkrirë atë akull të pavend në atë takim miqësor komandën e merrnin sytë që e ledhatonin me vështrim fytyrën e tij që ndoshta dikur kishte qenë vërtet e dashur për atë vajzë e mbase ishte edhe tani... dhe Olsi mos i kishte pasur fantazira ato që i kishte thënë... M'u ça koka, po mendoj marrëzira, përveç një mendimi që s'është marrëzi, se këtë vajzë e kam dashur dhe prapë e dua edhe pse është kurvë. Jo, s'është.



- Ç'po mendon? - Zëri i saj i tingëlloi me një ngrohtësi të dhimbshme dhe atij iu duk se ajo e mëshiroi dhe ai përbuzi veten.

- Asgjë.

Ajo i kapi dorën dhe ia shkundi lehtë për ta detyruar që ai ta shihte në sy.

- Fati, unë s'bëj dashuri me të.

Fatmiri u drodh dhe e pa në sy.

- Çfarë?

- S'bëj seks me të.

- S'bën dashuri?

- Jo.

- A je e dashura e tij?

- Jo.

- Si jo? - Ai u ndje tejet i habitur. I çakërdisur. Me një hutim në sy që i endej si një re e shtyrë nga era e moskuptimit. Dhe befas i shkrepri një dyshim se po vihej në lojë, çka e lëndoi thellë. - A rri me të? A shkoni lokaleve, hoteleve...

- Po.

- Dhe s'bëni dashuri?

- Jo.

Ai qeshi me tallje, por lehtë, për të mos e fyer. Asaj iu err vështrimi dhe iu drodhën buzët.

- Të betohem, Fati. Për shpirtin e mamit... për kokën tënde, nuk të gënjej.

- Kjo është absurde.

- Nuk është.

- Nuk e do?

- Nuk e dua.

- Pse u lidhe me të?

- S'jam lidhur.

- Ç'e ke, atëherë?

- Të njohur.

- Kur shkoni diku, a flini bashkë?

- Jo, pra!

- Si ka mundësi?

- Kemi bërë marrëveshje. Dhe ai s'ka tentuar ta shkelë. Po tentoi, ia jap duart në çast.

- Kjo është mizore.

- Vetë pranoi.

- Jeni lidhur me kusht?

- Po.

- Deri kur?

- Deri kur të dua unë.
- Dhe kjo kur të dua unë deri kur?
- S'e di. S'varet nga unë.
- Po nga kush?

Ajo heshti dhe ai pa se ajo qe zbehur dhe i dridheshin buzët, i dridhej dora që mbante gotën, të cilën e la mbi tryezë dhe ia kapi dorën Fatmirit sërish.

- Mos më pyet më shumë, Fati. Mos më bëj më asnjë pyetje, të lutem! - Ajo uli kokën mbi tryezë dhe e vështroi nga poshtë lart. - Të lutem.

- Keti, më do më?
- Mos më bëj më asnjë pyetje. Ma plotëso këtë dëshirë, të lutem, të paktën për ca kohë. Për pak kohë...
- S'të kuptoj, Keti. Sinqerisht, më dukesh kaq enigmatike.
- Mbase së shpejti do të mësosh për mua aq sa s'ke mësuar kurrë më parë.

Mirë, e dashur, tha ai me vete. Siç duket ke vendosur të më rrëfesh e nxitur nga ndonjë sinjal që mund të të ketë dhënë Olsi ose ndoshta nën trysninë e frikës se mos Madhori, duke u ndier përherë e më i rrezikuar nga sulmet e tua, ndihet i detyruar të më flasë për lidhjen tuaj, por sipas këndvështrimit të tij, duke i shtrembëruar gjërat sipas leverdisë së tij, çka ty doemos s'të pëlqen, ndaj edhe ti ndihesh e detyruar t'i paradalësh...

- Keti, të merr Olsi ndonjëherë në celular?
- Provon, por s'ia hap.
- Pse?
- Është më mirë ashtu.
- S'të vjen keq?
- Pikërisht pse më vjen keq s'ia hap.
- Po ai dëshiron të të flasë. Ndoshta e ndjek këtë acarim tëndin kundër të atit dhe mund të dojë të të ndihmojë me ndonjë këshillë, me ndonjë të dhënë të vlefshme për ty.

Ajo heshti pak.

- Ai s'para ka shkuar mirë me të atin, por prapë mua s'do të më ndihmonte në dëm të tij.

Fatmiri e humbi për një çast. Ai ndiente vështrimin e saj mbi sytë e tij dhe përfytyronte se ajo e hetonte me vëmendje.

- Ai të ka dashur shumë, Keti.
- E di. Qoftë edhe sikur të dojë të më ndihmojë, s'do t'ia hap.
- Ti e di.

Fatmiri papritmas u ndje i çliruar. Edhe sikur të kishte dashur, Olsi s'do të kishte mundur ta vinte në dijeni për rrëfimin që i kishte

bërë atij atë natë. Pra, ajo s'e dinte që ai e dinte të fshehtë e saj. Ndaj sillej aq natyrshëm. Por kjo s'do të thoshte se natyrshmëria e saj, madje betimi i saj se s'bënte dashuri me të dashurin e saj të ri... - gjë më të padëgjuar s'kam dëgjuar ndonjëherë, tha me vete... - do ta bënte t'ia falte lidhjen e saj me Bedriun. Jo. Sa herë e kujtonte atë, dhe e kujtonte papushim, i bëhej lëkura miza-miza.

Më fol pak për tregimin, i tha ajo, megjithëse s'të pëlqeu. Dua të më flasësh edhe sikur ta bësh fërtele. Mbase e lexova i nisur nga një paragjykim, Keti, se ti kërkon si e si të kritikosh Madhorin, tërthorazi, kuptohet. Aty e ke pasur hallin? Jo posaçërisht. Por ai mund ta marrë si goditje ndaj tij. Nëse i djeg, le ta marrë. Keti, s'ka shumë kohë që ne bëmë një bisedë për të. Me porosinë e tij, jo me dëshirën time. Por tani dua unë.

Ajo piu pak nga gota dhe vuri një kajsi të thatë në gojë. Përsëri për të? Në fillim për të, pastaj për ç'të duash ti. Oh, Fati, s'kam pikë dëshire të bisedoj për të. Mos ma prish, Keti. Ti ke një mllef ndaj tij, apo jo?

Ajo i dha një shkundje kokës, sa iu grafulluan flokët, dhe u zymtua në fytyrë.

- Sa herë do të ma bësh këtë pyetje?

- Jo më.

- Fati, ka bërë ndonjë bisedë Olsi me ty?

Kjo pyetje i erdhi krejt e papritur. Po të tregohej i sinqertë, do të shpërdoronte mirëbesimin e Olsit.

- Jo. Pse?

- Ai s'e ka qejf të atin, për diçka e bën fajtor, më duket se edhe aksidentin e vet e lidh me të.

Nga mënyra se si e vështronte, me një ngulm sikur donte ta zhbironte tejprtej, ai kuptoi se ajo s'e kishte ngrënë rrenën e tij kur ai i tha se Olsi s'kishte biseduar me të.

- S'kemi shoqëri, thjesht përshëndetemi. Por s'dua të bisedojmë për Olsin, por për Bedriun. Më saktë për rrezikun që mund të të vijë prej tij. Mos u merr me të, Keti. Mos u ngatërro me të. Këtë ta them për të mirën tënde, se pavarësisht vendimit tënd, unë të dua. Të dua shumë. Shumë.

Maskara, i tha vetes. E shkele që e shkele premtimin.

- Të mos flasim as për dashurinë, Fati, mirë?

Ai s'foli. Ajo surbi pak pije, futi dy kikirikë në gojë dhe me vështrimin mënjane i tha:

- Kam punuar pesë vjet me të. Kur të kesh punuar edhe ti aq, mbase do të vish te mendimet e mia për të.

- Që është drejtues i keq? Edhe mundet, po mos do ta rregulloj unë? Shansi i tij i mirë dhe shansi yt i keq është se populli ka simpati për të.

- Populli sheh skenën, jo prapaskenën. Unë e kam parë atë njeri në të tërën e tij... si drejtues, si politikan, si diplomat, si individ e madje si familjar. Nuk është se dua ta përmbys nga pushteti. Edhe po të doja, s'do t'ia dilja. Unë jam thjesht një gazetare, ai në majën e pushtetit, me mbështetje të gjerë, me miq të fuqishëm, unë një hiç. Duke i pasur parasysh këto, s'mund t'i bëj asgjë. Por s'ma ndal kush dorën ta kritikoj. Nëse kritikata e mia bëjnë që të bjerë nga pushteti, aq më mirë. Për mua mjafton të jem në rregull me ndërjegjen. Të them vetëm të vërtetën si për të, si për këdo tjetër.

- Pse je kaq e prerë kundër tij?

- S'dua të më bësh më asnjë pyetje për të, Fati. Këtë herë do të të jap një përgjigje të pjeshme, por më tej mos pyet më për të. Më premtan?

- Meqë do...

- Jam kundër tij, sepse është njeriu më i dyfytirshëm që kam parë në jetën time. Por njërin fytyrë, atë të fshehtë, rrallë ia sheh kush. Dhe mjerë ai që ia sheh, se ndodh si në atë legjendën e vjetër greke për Gorgonën, që kush ia shihte, kthehej në gur. Unë ia kam parë, Fati, dhe... - asaj iu drodh zëri dhe u përplot, - diçka tek unë është kthyer në gur... përjetë...

Fatmiri e pa me kureshtje, e habiti dhembja e saj, tronditja e saj.

- Ta zëmë se në njërin rast apo tjetrin ai është sjellë keq me ty, duhet ta sulmosh nga pozita vetjake?

- Ai që s'është njeri i mirë, s'mund të jetë as drejtues i mirë.

- Këtë lërja popullit ta gjykojë.

Ajo i dha kokës përjetë dhe ndërroi ton.

- Edhe unë jam pjesë e popullit, Fatmir. Siç më këshillon ti të mos ngatërrohem me të, dua edhe unë të të këshilloj: ik nga Ekzekutivi. S'e ke vendin atje.

- S'e kam vendin atje, apo sepse është ai atje?

- Të dyja. Edhe ai të mos ishte, prapë do të të këshilloja të ktheheshe te profesioni yt.

- Cili argument peshon më shumë?

- Që punon me të. Ik prej tij. Një orë e më parë.

- Ai sillet mirë me mua. Jo vetëm me mua, me të gjithë.

- E di. Veç rrogës, që e ke tri herë më shumë sesa si prokuror, ç'të tërheq tjetër atje?

- Po të kthehem në prokurori do të kem mbi krye një njeri të padurueshëm. Me Madhorin shkoj mirë.

- E kuptoj. Ti i gjykon vetë gjërat dhe unë s'do të ndërhyj më. Tani e mbyllim këtë bisedë?

- Si të duash.

- Më premtan që s'do të ma hapësh më çfarëdo emisioni a shkrimi të bëj për të?

- Jo. Nëse e godet, prapë do të ta hap.

- Nuk jam vajzë e vogël, Fati, di ç'bëj. Dakord?

- Eh. Nuk je vajzë e vogël, por je e çuditshme.

Ajo i kapi dorën dhe e vështroi ëmbël, me një buzëqeshje të hareshme në fytyrë.

- Vërtet vazhdon të më duash, Fati?

Ai u trondit. Po ti sa fytyra ke?, mendoi. Kur përmes tregimit të Olsit njoha atë fytyrën tjetër tënden, a s'm'u bë zemra gur edhe mua?

- Po. Ti vërtet s'je e lumtur me të?

- E lumtur?! Lumturi është ajo që vjen pas një kërkimi të etshëm, të dëshiruar me përgjërime... në ëndrra drithëruese gjatë gjithë jetës... Dhe ajo ishte me ty. Vetëm me ty.

- Dhe s'është më.

Ajo uli sytë mbi tryezë, por s'mundi të ndrydhte një buzëqeshje të trishtuar që i ndriçonte pjesën e sipërme të fytyrës, sidomos sytë dhe mollëzat. Ai ia përsëriti pyetjen.

- S'është më, apo jo?

- S'e di.

- Thuaj po ose jo.

- S'e di.

- E di.

- Vetëm hëpërhë s'është.

- Qoftë dhe hëpërhë, pse hoqe dorë prej saj?

- Së shpejti do të ta tregoj.

- Pse jo tani?

- Sepse të dua, Fatmir. Të dua, të dua, të dua shumë... - Ajo heshti për një grimë, u mendua, i kapi dorën dhe e pa në sy. - E di çfarë, Fati? Ti je bregu i këtejme dhe unë i përtejme i atij deti që quhet dashuri dhe që trazohet nganjëherë.

Ai u zverdh. Asaj iu mbushën sytë me lot.

- O Zot! Mos më bëj të çmendem. Mos e bëj këtë vajzë të më çmendë. E dëgjove për ç'iu luta Zotit, Keti?

- Po, - tha ajo me pëshpërimë.

- Atëherë?

- S'dua të të çmend, Fatmir. S'dua kurrë të të shkaktoj as të keqen më të vogël. Të premtoj se këtë bisedë do ta vazhdojmë dhe mbase

arrijmë... në ishullin tonë. Por, të lutem, mos më pyet më tej. Të lutem!

Ajo mori një kartëpicetë dhe fshiu sytë. Ai ia mbante dorën në dorën e tij pa e harruar rrëfimin e Olsit dhe përsëri iu shfaq vegullia e trupit të saj lakuriq me trupin e Bedriut lakuriq, por e përzuri me dhunë atë ninëz zhagmitëse dhe i tha Alketës se donte ta merrte atë natë në shtëpinë e tij, ose vij unë në tënden, Keti, të bëjmë edhe një herë dashuri dhe të premtoj se s'do të ta kërkoj më kurrë këtë, se po të ta kërkoja do të të poshtëroja, do të poshtëroja edhe veten time, dhe nuk është se kam nevojë për një femër, Keti, se femra gjej, por s'dua të gjej, se asnjë femër në botë s'të zëvendëson dot ty dhe dua të bëj edhe një herë dashuri me ty dhe pastaj do ta detyroj veten të mësohem pa ty derisa mbase, dozoti, lidhem me një tjetër dhe të harroj ty po qe se kjo do të jetë e mundur.

Ajo e shikonte pa ia ndarë sytë, me dhimbje a mall, ai s'e fillonte dot, nuk e lexonte dot atë dritësim të shkëlqimtë në sytë e saj, e kishte të pamundur të shquante ndjenjën e vërtetë në ta, se, dreqi e mori, keqardhja merret shpesh për dashuri, por ato ndryshojnë si nata me ditën, se ishte e hidhur e vërteta e ikjes së saj prej tij për një tjetër për të cilin ajo thoshte se s'kishte bërë kurrë dashuri, por ç'ishte ajo lidhje me të atëherë, absurde, e pakuptimtë, dhe ç'ishte historia e saj me Bedriun... të cilën s'mund të bënte dot kurrë për fjalë me të.

Jo sonte, Fati. Se kemi tjetër plan. Do të shkojmë tek *Ishulli Magjik*. Ah, Keti. Ai do të bëjë kaq shpenzime atje dhe a thua se është aq idiot sa të mos të të futë në krevat? Po jo, pra, Fati! Kemi bërë pakt. Sikur ta shkelë e të më përdhunojë, do ta vras. Po pse të pranon, atëherë? Si duron ai, xhanëm? A është mashkull normal? Nuk e di, Fati, s'kam si ta di. Ta zëmë se është, Keti, ty s'të vjen keq që torturohet? Jo. S'e kam detyruar unë. Kur më tha se më donte, i thashë se s'e doja, por s'isha kundër të shoqërohesha me të, madje edhe mund të flija në një dhomë me të, por s'do ta lija të më prekte as me majën e gishtit dhe nëse më lindte dashuria për të, do të bëhesha e tij. Kjo është e vërteta, Fati. Çudi, Keti. Çuditë edhe me ty, edhe me atë. Jam e detyruar të veproj kështu, Fati. Dhe s'e quaj viktimë, sepse s'e kam detyruar unë...

Iu drodh zëri dhe zuri të ngashërehej me fytyrën të mbështetur në një dorë, kurse me tjetrën mbante të shtrënguar fort dorën e Fatmirit. Më në fund mblodhi veten dhe piu ç'kishte mbetur në gotë.

Pranë tyre erdhi Xha Xhai me një gotë uji të mbushur me një pije të kuqërremtë.

- Mund të rri pak me ju? Ndihem i nderuar në shoqërinë tuaj.

Me sa dukej ishte paksa xurxull, sepse s'priti përgjigje, por u ul, piu një hurbë nga gota e vet dhe pa nga Alketa.

- Urime për tregimin, zojushë. Unë rrallë uroj, jam kritik i rreptë. Tregimi ishte i bukur, aktual.

- Falemnderit.

- Drastik, dramatik. Kam ëndërruar të shkruaj si ju.

- Dikur keni shkruar.

- Gjepura. Vonë kuptova se jam lindur për kritik.

- Po pse kritikoni aq hidhur, Xha Xha? Hyra një ditë në Internet dhe pashë se thoni: të pastrojmë *Leksikonopedinë Letrare* nga ata që i ngrenë monumente vetes në Internet, nga plehrat. Nuk mendoni se kështu jeni ju që doni t'i ngrini monument vetes? Se askush nuk shkruan për ju, por jeni ju që shkruani për veten tuaj?

Xha Xhai qeshi duke zbuluar ca dhëmbë të rrallë e të krimbur.

- E ç'ë? Unë bëj detyrën përpara historisë.

- Një shkrimtar ju quante plehrë.

- S'prish punë. - Ai pa nga Fatmiri. - Qentë le të lehin, karvani të shkojë drejt. Apo jo, z. këshilltar?

- Qentë s'i lehin kryetarit, - ia ktheu Fatmiri si me të qeshur dhe me vete mendoi se ku drejtin më qepet ky idiot dhe iu kujtua ajo natë në Karaoke me Jonidën dhe ndoshta ai gërxiho i rrjedhur do ta pyeste për të, për vajzën e Madhorit, mikut të tij, por duket atij nuk iu kujtua ndoshta ngaqë i bënin sytë lylas nga pija dhe Fatmiri iu kujtua ajo barceleta e violonçelit dhe i erdhi për të qeshur.

- Unë jam edhe analist politik dhe e di përse e vlerësoj Madhorin? Për idetë e tij të mëdha. Për shembull, ideja e tij që në distriktin tonë të flitet vetëm anglisht është gjeniale.

Xha Xhai ia nguli sytë një burri të moshuar me flokë të bardhë që i vareshin të paqethur, i ulur dy tryeza më tej, me kokën të mbështetur në duar, i palëvizuar si statujë.

- Është studiues folklori, - tha Xha Xhai për të. - Kur doli vendimi që shqipja të zëvendësohet me anglishten, protestoi. Si do t'ia bëjmë me krijimtarinë folklorike?, tha. Vërtet debil. Ne ku ta gjejmë që folklori ynë të përkthehet në anglisht. E kanë çuar mësues në fshat dhe pas 2 vjetësh do të japë provim anglishten.

- Sa vjeç është?

- 75.

- Pse s'ka dalë në pension?

- Është shkencëtar, akademik. Këtij i them përparim unë. Do të hysh në Evropë? Dua. Atëherë mëso anglisht, i ri apo i vjetër. Jepi!

Xha Xhai qeshi gjithë qejf dhe futi në gotë hundën e tij të madhe sa një patllixhan. Alketa i bëri shenjë Fatmirit të ngriheshin. Përshtëndetën Xha Xhain, që vazhdonte të pinte, dhe dolën.

U drejtuan te parkingu. Teksa ajo po hipte në makinën e saj, ai i tha:

- Dua të vish, Ketë. Për herë të fundit...

Ajo qëndroi për disa çaste e menduar, me vështrimin të hedhur diku anash.

- Dakord. Por mos ma kërko më. Mirë?

- Mirë.

Ndodhej në një prej atyre çasteve kur kujtimet përflaken, jeta bëhet e ndritshme dhe njeriu përjeton një ringjallje që s'ka besuar kurrë se do t'i rikthehet. Një lloj hovi i ngrihej nga thellë qenies dhe gëzimi, që s'kishte nevojë për shpjegim, i buronte vetiu, një ato gëzimet e pakta të marra që provon njeriu dhe që i harron sakaq, por gjithsesi çasti jetonte, ishte pavdekësia e çastit, këndellja e jetës që ia gufonte zemrën pakuptueshëm si një puhi e freskët në një ditë zhegu dhe që s'e kupton se nga vjen.

Lëkura e saj lëshonte një refleks të zbehtë, flokët i qenë zgrafulluar si një bujanë e valëvitur nga era dhe sytë i shkëlqenin si dy perla me një dritësim hënëze në mes dhe kur ajo ngriti duart të zbërthente gjimbajtëset atij iu duk se ajo po kryente një rit të lashtë dhe u lëshua mbi të, por befaz u ndal i pickuar nga mendimi se po përfitonte nga një akt bamirësie dhe i kaplluar nga një ndjenjë përçmimi të përzier me ashkun e dëshirës... e gjeti veten në një dyzim ndjesish dhe ndërsa e tundonte gjakimi për t'ia thithur gjinjtë, pati ngasjen t'i futej me shpulla. Ajo e shikonte e hutuar, drita kishte ngrirë në sytë e saj dhe tani ata dukeshin sikur thithnin errësirën e dhomës në një shtangie moskuptimi.

Ajo vuri krahët e zhveshur mbi parzmin e tij dhe ai ndjeu ngrohtësinë e saj t'i përshkonte lëkurën, e kishte ndier aq herë atë ndjesi, por këtë herë ishte ndryshe, pezmatuese, diçka si kënaqësi hajduti, mendoi, apo si e përftuar nga përdhunimi. I dukej e habitshme që ai trup s'i përkiste më dhe i bëhej se ishte gati të shihte një film të vjetër duke pritur me ankth nëse skenat e njohura do të ishin si dikur... shihte shkëlqimin e trupit të saj nga barku te kofshët, lëmuetsinë e gjinjve të saj me thimthat bojë rozë dhe gjithçka iu përtëri e bukur, madje më e bukur, ishte shijimi i gjësë së ëndërruar ethshëm... Dhoma mbushullonte me mrekuellinë e magjisë së trupit të saj, një magji që do të merrte fund pas kësaj nate dhe përtej saj ai s'do të mund të shkelte më, i qe ndaluar të shkelte, madje edhe të mendonte për të... një humnerë hapej frikshëm mes tij dhe asaj...



magjia e saj do të qëndronte përtej mendimeve të tij dhe nëse ndonjëri do të depërtonte deri tek ajo, ai do të shitohej prej saj, por s'është në dorën time, thoshte me vete, mjafton që sonte u bëra pjesë e kësaj shurdhëtie drithëruese dhe e shurukamës së detit të dashurisë së saj...

Ajo e shihte me një butësi njomështie të ëmbël. Është seksi tek ajo, mendonte ai i zhytur brenda saj, jo magjia e dashurisë. Tek unë është dashuria, çmenduria, marria... ngjitja e shpirtit tim pas saj që s'besoj të më kalojë kurrë, kurse për të dashuria është grip, herë e zë një virus, herë një tjetër, herë me përçartje, herë jo, por e hedh. Është një dashuri-seks-grip që e lumturon. Lumturia për të është e tashmja dhe kurrë e shkuara, ajo s'është si të tjerët që e vlerësojmë lumturinë ca më shumë kur s'e kanë dhe kur hija e saj i ndjek nga pas kujtojnë se ajo ka qenë aq e plotë, si deti, dhe ata laheshin në të, kurse deti i dashurisë së saj tani është tharë, ndonëse ajo e mohon...